

# RELACION

## PËR

### **PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7895, datë 21.1.1995, “KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”**

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Qëllimi kryesor i këtij projektligji është plotësimi i vakuimit ligjor të krijuar në Kodin Penal, me vendimin nr.9, datë 26.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese. Në këtë vendim Gjykata Kushtetuese vendosi shfuqizimin e paragrafëve të pestë dhe të gjashtë, të nenit 278, të Kodit Penal, shtuar me ligjin nr.144/2013, ndryshuar me ligjin nr.98/2014.

Këto dy paragrafë parashikonin se: “Mbajtja e armëve, e bombave apo minave, ose lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur vepra penale kryhet në sasi të mëdha, në bashkëpunim, më shumë se një herë, ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë deri në njëzet vjet.”.

Në kushtet e shfuqizimit të këtyre dy paragrafëve, me arsyetimin se mbartin probleme kushtetutshmërie, për shkak të dënimit dukshëm joproportional, në Kodin Penal mbetej e paparashikuar si rrethanë e posaçme mbajtja e armëve, bombave, minave dhe lëndëve plasëse në mjetet e motorizuara apo në mjedise publike, që, për shkak të rrezikshmërisë që paraqet, në krahasim me mbajtjen e tyre në banesë, duhet të dënohet me një masë dënimi më të ashpër.

Gjithashtu, ndërmarrja e kësaj nisme është kërkuar dhe nga Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën me nr.970 prot, në datën 23.3.2016, dhe nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me shkresën me nr.1006/1 prot., datë 30.3.2016, si pasojë e shqetësimit të ngritur nga Prokuroria e Përgjithshme në shkresën e sipërcituar.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Ky projektligj nuk është pjesë e programit analitik të akteve të Këshillit të Ministrave për vitin 2016.

## **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Në zbatim të vendimit nr.9/2016, të Gjykatës Kushtetuese, propozohet riformulimi i nenit 278, të Kodit Penal, që ka ndryshuar disa herë ndër vite. Vepra penale e prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe të municionit, e parashikuar si e tillë në Kodin Penal të vitit 1995, ka pësuar ndryshime në kohë pesë herë, përkatësisht në vitet 1998, 2001, 2013, 2014 dhe 2015.

Për pasojë, ashtu siç është shprehur dhe vetë Gjykata Kushtetuese, një ndryshim i tillë ka rrezikuar të cenojë aspektin harmonik që duhet të kenë dispozitat e Kodit Penal, të cilat në tërësinë e tyre duhet të përbëjnë një entitet të vetëm, ku të bashkohen vlerat dhe parimet kryesore që udhëheqin këtë kod, që janë shteti i së drejtës, barazia para ligjit, drejtësia në caktimin e fajësisë e të dënimit, si dhe humanizmi (*neni 1/c i Kodit Penal*).

Megjithatë, parashikimi si rrethanë e posaçme e mbajtjes së armëve, bombave apo minave ose lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, si dhe parashikimi i një dënimi relativisht më të ashpër kur vepra penale kryhet në sasi të mëdha, në bashkëpunim, më shumë se një herë, është i nevojshëm. Në nenin e riformuluar tërësisht, në funksion të qartësisë së normës juridike, është synuar që përcaktimi i një mase proporcionale dënimi, jo vetëm të synojë uljen e kriminalitetit, por duhet të jetë realisht efektiv, në mënyrë që t'i shërbejë në radhë të parë parandalimit të veprave penale.

Përcaktimi me ligj i veprave të reja penale, si dhe caktimi i llojit dhe i masës së dënimit për to është në diskrecion të ligjvënësit, në përputhje me nevojat e vendit dhe të shoqërisë për parandalimin e kriminalitetit. Balanca mes së drejtës së kufizuar dhe interesit publik nuk është gjë tjetër veçse gjetja nga legjislatori e pikës së ekuilibrit midis së drejtës së shtetit për të siguruar rendin publik e shoqëror, nga njëra anë, dhe mbrojtjes të të drejtave dhe lirive të individit, nga ana tjetër. Për këtë arsye dhe për sa është shprehur Gjykata Kushtetuese,

sanksionet penale të propozuara në nenin 278, të riformuluar, janë menduar të jenë në përputhje me parimin e proporcionalitetit, veçanërisht për nga rëndësia me vlerat që mbrojnë.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji i propozuar mbështetet në nenet 81, pika 2, shkronja “d”, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

Ky projektligj është bashkërenduar me Gjykatën e Lartë dhe mendimet e Unionit të Gjyqtarëve janë reflektuar.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)**

Projektligji nuk synon përafrimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Unioni i Gjyqtarëve ka sugjeruar shfuqizimin e paragrafit të dytë, të nenit 55, të Kodit Penal, në përputhje me vendimin nr.9/2016, të Gjykatës Kushtetuese. Ky vendim shpalli antikushtetues paragrafin e dytë, të nenit 55, të Kodit, shtuar nga Kuvendi me nenin 9, të ligjit nr.144/2013. Ky vendim, i cili u bë publik (por nuk u botua në “Fletoren zyrtare”) në mesin e dhjetorit 2015, nuk mund të merrej në konsideratë nga Kuvendi, i cili, me ndryshimet e bëra me ligjin nr.135/2015 ka shtuar edhe tri vepra të tjera penale, për të cilat detyron gjykatën të zbatojë bashkim aritmetik të dënimeve të dhëna, në rast të shpalljes fajtor të të pandehurit, duke riformuluar paragrafin e dytë të nenit 55.

Neni 278 propozohet të riformulohet, duke parashikuar se:

“Mbajtja e municioneve luftarake, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

Mbajtja e armëve në banesë, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

Mbajtja e armëve shpërthyes ose lëndëve plasëse në banesë, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.

Mbajtja e armëve, e armëve shpërthyesë ose lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

Falsifikimi ose fshirja, zhvendosja ose ndryshimi i paligjshëm i shenjave mbi armët dhe municionet luftarake dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. Prodhimi, shitja, blerja, ofrimi për shitje, tregtimi dhe transportim i armëve dhe i municioneve luftarake, lëndëve plasëse, i armëve shpërthyesë, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

Po kjo vepër e parashikuar nga paragrafi i gjashtë i këtij neni, kur kryhet në sasi të mëdha, në bashkëpunim, më shumë se një herë, ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.”.

Kuptimi i termave “armë” dhe “armë shpërthyesë” është i përcaktuar në ligjin nr.74/2014, “Për armët”. Sipas këtij ligji, “armë” konsiderohet çdo mjet ose vegël e përgatitur me qëllim që, nën presionin e gazrave, të cilat shkaktohen gjatë djegies së lëndëve shpërthyesë, elektricitetit, gazrave, të hedhë predha në formë plumbi, grumbulli prej saçmash, gazi, lëngu, shigjete që shkaktojnë dëm fizik a psikologjik. Ndërsa “armë shpërthyesë” nënkupton kryesisht çdolloj bombe, mine, rakete, granate apo mjete tjetër që përmban lëndë plasëse apo materiale ndezëse, ndaj të cilave, për shkak të proceseve të brendshme apo të jashtme (peshës, ndikimit, fërkimit, reagimit kimik, energjisë elektrike dhe të ngjashme), shkaktohet lirimi apo krijimi i energjisë dhe eksplozimit.

“Armë shpërthyesë”, gjithashtu, konsiderohen pjesët e eksplozivëve, detonatorët, mjetet piroteknike apo pjesët e tjera, për të cilat qartazi duket se janë të paracaktuara për përgatitjen e armëve shpërthyesë. Ky përkufizim është i paracaktuar të përfshijë armët termobarike, të cilat dallohen nga armët konvencionale eksplozive, për shkak se funksionojnë me oksigjen atmosferik dhe nuk kanë oksidues në eksplozivët e tyre. Po ashtu, quhen armë termobarike me impuls të lartë (TIL), eksploziv karburant-ajër (EKA apo FAX), e nganjëherë quhen edhe municione karburant-ajër, armë me nxehtësi dhe shtypje apo bomba vakumike.

Nga procesi i konsultimit të projektaktit të përgatitur nga ana e Ministrisë së Drejtësisë erdhën dhe disa sugjerime nga Unioni i Gjyqtarëve, të cilat janë reflektuar në projektligj, si dhe nga Unioni i Prokurorëve të Republikës së Shqipërisë, siç ishte propozimi për shfuqizimin e plotë të paragrafit të dytë, të nenit 55, të Kodit Penal, dhe riformulimi i nenit 279.

## **VII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Miratimi i këtij projektligji nuk sjell efekte financiare negative për buxhetin e shtetit.

### **KËSHILLI I MINISTRAVE**